

ZBULUESIT

Viti 1 - Tremujori 4

Programi Bazë



NJË MESAZH NGA KRIS SMOLL



Të dashur drejtues,

Këtë tremujor, gjeni paqe duke ditur se i shërbejmë Perëndisë së vetëm të madh e të plotfuqishëm. Ai ju do dhe ka një plan të bukur për jetën tuaj, siç kishte edhe për Jozefin dhe Moisiun. Më pëlqen shumë vargu nga Eksodi 14:14: “Zoti do të luftojë për ju, dhe ju do të rrini të qetë.” Perëndia juaj është për ju!

Kjo është shumë e fuqishme, e megjithatë shumë nga nxënësit tanë e mohojnë fuqinë e Perëndisë dhe të Fjalës së Tij. Ndërsa shpjegon mësimet këtë tremujor, kujtoju nxënësve se Fjala e Perëndisë është e vërtetë. Provat historike, profecitë dhe dëshmitarët okularë janë vetëm disa nga mënyrat për t'i ndihmuar nxënësit të jenë të bindur se ato gjëra që ti u mëson janë të sakta dhe mund të jenë baza të besueshme ku ata të ndërtojnë jetën e tyre. Gjithashtu, vazhdoni t'i inkurajoni nxënësit t'i marrin Biblat me vete dhe t'u mësoni si t'i përdorin, që t'i studiojnë vetë në të ardhmen.

Tani, detyra jote e dhënë nga Perëndia është t'u mësosh nxënësve të tu. Mëso, modelo dhe lejo që gëzimi i Jezusit të rrjedhë përmes teje çdo javë. Pavarësisht cili është pozicioni yt, shërbe me pasion, përkushtim dhe me zemër shërbëtori. Shiko se si Perëndia lëviz në mënyra të fuqishme ndërsa lutesh me përkushtim për nxënësit që Ai të ka caktuar.

Zoti që luftoi për izraelitët, lufton edhe për ty dhe për nxënësit e tu!

Kris Smoll

Drejtoreshë ekzekutive e Discovery Land Global

TABELA E PËRMBAJTJES

Viti 1 – Tremujori 4

Të kuptojmë kurrikulën	4
Përmbledhja e tremujorit – Pjesa 1.....	9
Mësimi 1: Vëllezërit e Jozefit e shesin atë si skllav.....	10
Mësimi 2: Perëndia është me Jozefin në Egjipt.....	18
Mësimi 3: Jozefi interpreton ëndrrat në burg.....	24
Mësimi 4: Jozefi i fal vëllezërit e tij.....	30
Përmbledhja e tremujorit – Pjesa 2.....	38
Mësimi 5: Lind Moisiu.....	39
Mësimi 6: Perëndia e dërgoi Moisiun që të çlironte popullin e Tij.....	45
Mësimi 7: Perëndia dërgoi plagët.....	52
Mësimi 8: Perëndia dërgon plagën e fundit.....	59
Mësimi 9: Perëndia e çliron popullin e Tij nga egjiptasit.....	65
Mësimi 10: Mençuria e vërtetë vjen nga Fjala e Perëndisë.....	71
Shtojca	
Mësim tematik: Rishikim i Dhiatës së Vjetër.....	75
Mësim tematik: Administrimi, pjesa 1 – E dhjeta	81
Mësim tematik: Administrimi, pjesa 2 – Dhuntitë frymërore.....	87
Lojërat e fundit të përsëritjes	94
Libri pa fjalë – T'u prezantojmë fëmijëve ungjillin	99
Mirënjohje dhe falënderime	101

TË KUPTOJMË KURRIKULËN

Pasqyrë e përgjithshme

Kurrikula është hartuar për të qenë ARGËTUESE, PËRFSHIRËSE dhe EFEKTIVE, në mënyrë që t'i motivojë fëmijët ta njohin dhe ta duan Perëndinë. Ajo është strategjike dhe e qëllimshme, dhe merr parasysh zhvillimin shpirtëror të fëmijëve të moshës nga gjashtëmuajsh deri në 9 vjeç.

Kurrikula u hartua për t'i mësuar nxënësit në lidhje me:

1. **Biblën:** pamjen e përgjithshme të Dhiatës së Vjetër dhe Dhiatës së Re si një të vetme, zbuluesën e unifikuar të së vërtetës së Perëndisë për ne.
2. **Ungjillin e Jezusit:** shpëtimin me anë të hirit përmes besimit siç paraqitet në të gjithë Biblën.
3. **Bazat e krishterimit:** transformimin e jetës përmes lutjes, adhurimit, ungjillëzimit, mësimit përmendsh të Shkrimit, pagëzimit, Darkës së Zotit, të dhjetës, bashkësisë, shërbesës, misionit etj. (Listën e plotë sipas grup-moshave, mund ta gjeni në Hartën e gjurmuesit).

Mësimet bazë mbështeten në strukturën:

KUPTO SI DUHET → MENDO SI DUHET → VEPRO SI DUHET → NDIHU SI DUHET

Kupto si duhet:	Një pasazh kyç nga Shkrimi – 2 e Timoteut 2:15
Mendo si duhet:	Një varg kyç nga Shkrimi për të medituar gjatë javës – Psalmi 1:2
Vepra si duhet:	Sfida për të vënë në praktikë Fjalën e Perëndisë – Jakobi 1:22
Ndihu si duhet:	Rezultati i zbatimit të mësimit dhe të të pasurit e një botëkuptimi biblik në vend të një pikëpamjeje laike – Psalmi 23

Drejtuesit

Çdo klasë ka zakonisht tre drejtues: Mësuesin kryesor, Drejtuesin e kohës së zbulimit dhe Bariun.

Mësuesi kryesor: Është përgjegjës për mësime të qëndrueshëm biblik, që tërheq vëmendjen e nxënësve dhe krijon një rritje shpirtërore për ta duke ndjekur kurrikulën, si dhe siguron udhëheqje për nxënësit dhe vullnetarët gjatë takimit.

Drejtuesi i kohës së zbulimit: Është përgjegjës për udhëheqjen e Kohës së zbulimit, një aktivitet prej 15 minutash, i cili është edukativ, energjik, ndërveprues dhe ka në bazë ekipin, siç citohet në kurrikul.

Bariu: Është përgjegjës për nxitjen dhe trajnimin e nxënësve gjatë gjithë takimit, duke përfshirë lidhjen e tyre me një mik dhe ndihmon ata që vijnë për herë të parë, të ndihen të mirëpritur.

Këshilla për drejtuesin

Të gjithë drejtuesit duhet të qëndrojnë gjatë gjithë mësimit në klasë duke u angazhuar me nxënësit dhe duke i ndihmuar ata sipas nevojës.

Për grupe më të vogla, Drejtuesi i kohës së zbulimit dhe Bariu mund të jenë i njëjti person.

Pasqyra bazë e programit

Programi përbëhet nga pesë elemente:

1. Loja e përsëritjes
2. Adhurimi
3. Koha e zbulimit
4. Mësimi nga Bibla
5. Loja e fundit e përsëritjes

Këto pjesë janë të lidhura fort me njëra-tjetrën, të cilat krijojnë një ambient mësimi me kohë të plotë, ku çdo minutë është e rëndësishme dhe çdo nxënës përfshihet për të mësuar pikat kryesore të mësimit apo një objektivi të Hartës së gjurmuesit.

Program i sugjeruar

-: 20 Vullnetarë të gatshëm dhe të përgatitur për të mirëpritur nxënësit teksa mbërrijnë
-: 15 Loja e përsëritjes
: 00 Adhurimi
: 15 Koha e zbulimit
: 30 Mësimi nga Bibla
: 60 Loja e fundit e përsëritjes
: 65 Marrja e nxënësve nga prindërit

Loja e përsëritjes

Këshilla për drejtuesin

Drejtuesit të cilët nuk janë duke i mirëpritur nxënësit ndërsa hyjnë në klasë, duhet t'i ndihmojnë dhe t'i nxisin ata gjatë Lojës së përsëritjes. P.sh, Duke brohoritur!

Sigurohu që vizitorët të ndihen të mirëpritur dhe përpiku t'i bashkosh me një mik të ri nga klasa jote.

Loja e përsëritjes është krijuar që të jetë argëtuese dhe energjike, për të rishikuar mësimet dhe temat e mëparshme nga Harta e gjurmuesit. Koha shfrytëzohet më së miri teksa fëmijët vijnë dhe për prindërit është gjëja e parë që shohin!

Udhëzimet për lojën e përsëritjes gjenden te shtojca.

Adhurimi

Këshilla për drejtuesin

Inkurajo nxënësit të jenë të respektueshëm dhe të marrin pjesë duke bërë lëvizjet e caktuara të këngëve, dhe/ose duke qëndruar thjesht në këmbë në shenjë respekti. Drejtuesit duhet të parandalojnë dhe të korrigjojnë çdo lloj sjellje shqetësuese.

Adhurimi është hartuar për të:

- paraqitur mësimin e ditës
- mësuar se çfarë është adhurimi
- modeluar adhurimin autentik
- nxitur pjesëmarrjen në adhurim

Në një javë të zakonshme, adhurimi përmban dy ose tre këngë. Kurrikula e adhurimit gjendet te shtojca.

Koha e zbulimit

Aktivitetet e Kohës së zbulimit (KZ) janë krijuar për t'i angazhuar dhe sfiduar nxënësit përmes mësimit praktik. Përmes KZ-së, ata do të përjetojnë një emocion ose një reagim që do t'i ndihmojë të lidhen personalisht me mësimin e Biblës. Ndonjëherë aktiviteti i KZ-së do të përdoret për të krijuar një "pamje të paharrueshme" të mësimit biblik, siç mund të jetë një ndjenjë, një aromë apo një shije e diçkaje te rrëfimi i Biblës.

Këshilla për drejtuesin

Sigurohu që të kuptosh paraprakisht se si KZ-ja lidhet me mësimin dhe se si do të funksionojë aktiviteti. Nëse nuk je i sigurt, kontakto drejtuesin e shërbesës. Dhe mbaj mend, drejto me entuziazëm; KZ-të janë pjesë emocionuese e takimit të fëmijëve!

Mësimi nga Bibla

Mësimi i Biblës është një përvojë e udhëhequr nga mësuesi, i cili e bën Biblën të gjallë për nxënësit. Ungjilli është i ndërthurur në çdo mësim. Atje ka një skicë të Shkrimit për të ndihmuar në udhëheqjen e mësimi:

Kreu i seksionit: Ky informacion është vetëm për mësuesin (jo për dialog).

Lexo: Shkrime nga Bibla për t'ia lexuar nxënësve me zë të lartë.

Përmbledhje: Pasi të keni lexuar pjesën nga Shkrimi, merr kohë për t'u shpjeguar se çfarë do të thotë ajo pjesë. "Përmbledhja" shpesh bën një pyetje, përcakton fjalët kyç, ose rishpreh tablonë e asaj që lexuat, në nivelin e një fëmije.

Parafrazim: Kjo do të thotë se nuk keni nevojë ta lexoni pjesën drejtpërdrejt nga Bibla (për shkak të kohës, gjatësisë së vargjeve, ose për shkak se mbulon një temë të vështirë që duhet të bëhet më e përshtatshme për fëmijët). Ju lutemi, mos e lexoni tekstin e parafrazuar drejtpërdrejt nga kurrikula.

Hapat e sugjeruar për përgatitjen e mësimit nga Bibla:

1. Lutur për drejtimin dhe udhëheqjen e Perëndisë! Gjithashtu kalo kohë duke u lutur për nxënësit e tu emër për emër.
2. Lexo Shkrimin nga Bibla jote – nënvizo pikat kryesore! Kjo kurrikul është hartuar mbi themelin e Fjalës së Perëndisë dhe mësimit rreth të vërtetës së Tij nga Fryma e Shenjtë. Është e rëndësishme që të gjithë drejtuesit të lexojnë fragmente nga Shkrimi, përpara se të lexojnë skicën e mësimit nga Bibla. Kurrikula mund të përmbajë gabime, por Bibla është e pagabueshme.
3. Lexo pyetjet shqyrtuese të mësimit!
4. Lexo kurrikulën!
5. Planifiko mësimin! Sigurohu që të përdorësh kalimin e aktivitetit të KZ-së për të prezantuar dhe/ose theksuar pikën “Vepra si duhet” të mësimit.
6. Bëje mësimin më të gjallë duke përdorur mjete, figura apo veprime, si dhe duke përdorur ide krijuese nga kurrikula.
7. Praktiko mësimin në mënyrë që “t’i jepni jetë Biblës”, duke pasur emocion në zë dhe kontakt të mirë me sy.
8. Mësuesit duhet t’i kenë Biblat e hapura gjatë gjithë mësimit, në mënyrë që nxënësit të dinë se ngjarja vjen nga Bibla. Të gjithë nxënësit duhet t’i hapin Biblat te pasazhi nga Shkrimi siç i drejton mësuesi (shih seksionin “Gjejen!” në prezantimin e mësimit). (Nxënësit më të vegjël mund të kenë nevojë për ndihmë.) Për shkak të kohës së limituar dhe vlerës që i japim përdorimit të Biblave nga nxënësit, ju lutemi mos e lexoni mësimin nga një libër me histori biblike.

Loja e fundit e përsëritjes

Lojërat e thjeshta të përsëritjes i gjeni te shtojca e kurrikulës. Drejtuesit e kohës së zbulimit ose Barinjtë drejtojnë lojën e përsëritjes ndërsa prindërit janë duke marrë fëmijët. Mësuesi kryesor shpërndan Etiketat shpërbluese dhe lidhet me prindërit.

Këshilla për drejtuesin

Shpërbleji pyetjet përsëritëse! Mund t’i kthesh në pyetje E vërtetë/E gabuar ose në pyetje me alternativa, si të përshtaten më mirë për moshën dhe nivelin e klasës.

Materialet për klasën

Për mësimin iu jepen materialet e mëposhtme:

- Kronologjia e Biblës
- Libri pa fjalë
- 12 vargjet kyç
- Fletushka *T'i udhëzosh fëmijët drejt shpëtimit*
- Broshura *E beson apo jo?*
- Libër shënuesi *Unë besoj*
- Broshura *Çfarë ndodh më pas?*
- Postera me librat e Dhiatës së Vjetër dhe të Re
- Etiketat shpërblyese
- Posterit *Ndihuni si duhet*
- Harta e kohëve të Biblës

Etiketat shpërblyese

Etiketat shpërblyese mund të fitohen nga nxënësit gjatë mësimin dhe të shpenzohen më pas në Tregun e zbulimit.

Kursi i këmbimit:

- 3 Marrja e Biblave me vete (për fëmijët më të vegjël)/ Përdorimi i Biblave (për më të rriturit)
- 2 Pjesëmarrja aktive në klasë
- 1 Shfaqja e frytit të Frymës
- 1-5 Aktivitetet e Kohës së zbulimit (specifikuar në kurrikul)
- 5 Plotësimi i Thesarit të gjurmuesit dhe kthimi i kuponit
- 10 Vizitori dhe miku që sjell vizitorin

Thesari i gjurmuesit

Thesaret e gjurmuesit janë letra shumëngjyrëshe, të përshtatshme për fëmijët dhe familjet që t'i marrin në shtëpi. Është një mënyrë shumë e mirë për të krijuar bashkëpunim me prindërit. Thesari i gjurmuesit i edukon për atë që po mësojnë fëmijët dhe i sfidon ta aplikojnë mësimin në shtëpi gjatë javës. Pasi të plotësohet aktiviteti sfidues si familje, nxënësit mund të kthejnë kuponin te mësuesi dhe të marrin pesë Etiketa shpërblyese.

PËRMBLEDHJE E TREMUJORIT

PJESA 1

Viti 1 – Tremujori 4

Pjesa 1 – Jozefi

Shkrimi: Zanafilla 37-45

“Dhe ne e dimë se të gjitha gjërat bashkëveprojnë për të mire për ata që e duan Perëndinë, për ata që janë të thirrur sipas qëllimit të tij.” Romakëve 8:28

Sfondi biblik: Për shkak të besimit të Abrahamit, Perëndia bëri një besëlidhje të veçantë me të për t'i dhënë tokën e Kanaanit pasardhësve të tij. Premtimi do të përmbushej përmes birit të Abrahamit, Isakut. Isaku kishte dy bij; i parëlinduri ishte Esau dhe i dyti ishte Jakobi. Për shkak të mungesës së besimit të Esaut, ai ia shiti pjesën e trashëgimisë së tij dhe bekimin e parë të Jakobit për një pjatë me supë. Jakobi kishte dymbëdhjetë bij. Bijtë e Jakobit e tradhëtuan villain e tyre Jozefin dhe e gjithë familja përfundoi në tokën e Egjiptit. Ata shpëtuan nga një zi e tmerrshme buke që plani sovran i Perëndisë dhe qëllimi i Tij për t'i kthyer pasardhësit e Jakobit në tokën e Kanaanit të përmbushej. Kjo ishte toka që fillimisht i qe premtuar Abrahamit. Në këtë tokë lindi Jezusi, aty jetoj, vdiq dhe u ringjall.

Këndvështrimi: Perëndia kishte një plan të jashtëzakonshëm për Jozefin. Ai i njihte ditët e Jozefit nga e para tek e fundit. Përmes çdo situatë, Perëndia ishte i pranishëm duke drejtuar Jozefin dhe njerëzit përreth tij. Kështu, në fund të udhëtimit sfidues të jetës së tij, Jozefi të mund të kthente kokën mbrapa dhe të shihte dorën e Perëndisë në çdo hap. Duhet t'i sfidojmë nxënësit të kërkojnë Perëndinë në jetën e tyre. Ai është i fuqishëm, aktiv dhe vepron!

Ta bëjmë të vërtetë: Pjesa e parë është shkruar për t'i sfiduar nxënësit të mos jenë të përqëndruar tek vetja por tek Perëndia. Përballja me situata familjare sfiduese, përballja me rrethana të padrejta, përfitimi i suksesit të drejtë dhe aftësia për të falur të tjerët, janë gjëra që bëhen vetëm kur vendosim vullnetin tonë mënjanë dhe e bëjmë Perëndinë qendrën e jetës sonë. Mund ta vendosim Perëndinë në qendër kur e dëgjojmë dhe i bindemi Atij. Kjo do të bëjë që ne të kuptojmë se Perëndia ynë është i vërtetë, i fuqishëm dhe i dashur. Perëndia ka një plan për jetën tonë dhe Ai është në kontroll të gjithçkaje.

MËSIMI 1

Zanafilla 37

Kupto si duhet:	Vëllezërit e Jozefit e shesin atë si skllav.
Mendo si duhet:	“Ki besim tek ZOTI me gjithë zemër dhe mos u mbështet në mençurinë tënde; pranoje në të gjitha rrugët e tua dhe ai do të drejtojë shtigjet e tua.” Fjalët e Urta 3:5-6 (12 vargjet kyç)
Vepro si duhet:	Unë do të besoj në Perëndinë për planin e Tij për jetën time.
Ndihuhet si duhet:	Unë mund të ndihem i sigurt për dashurinë e Perëndisë, për shkak se Ai ka një plan për jetën time.

PËRGATITU!

T'i besosh vërtet Perëndisë për planin e Tij për jetën tënde nuk është gjithmonë e lehtë. Kur gjërat nuk shkojnë ashtu siç shpresojmë ne, ose e gjejmë veten në një periudhë pritjeje, Perëndia do që të dimë se Ai na do, dhe se ne mund t'i besojmë plotësisht Atij dhe planeve të Tij.

Lutu: Lutu që Perëndia të të japë të kuptuarit e qartë të Shkrimit dhe që nxënësit në klasën tënde të kuptojnë se Perëndia ka një plan për secilin prej tyre.

Lexo: Zanafilla 37

Kupto si duhet: Vëllezërit e Jozefit e shitën atë si skllav.

BËHU GATI!

Shënime për mësuesin kryesor:

- Kini parasysh që në dy tremujorët e kaluar, nxënësit ishin në Dhiatën e Re. Kurikula fokusohet në Dh.V. gjatë tremujorit të parë, pastaj kalon në Dh.R. në tremujorin e 2-të dhe atë të 3-të, duke u kthyer në fund te Dh.V. për tremujorin e 4-t. Tek tremujori 1-rë përfundam me Abrahamin dhe tani në tremujorin 4-t do të kalojmë tek jeta e Jozefit.
- Ndaluhet dhe mendo pak për faktin e mrekullueshëm se Perëndia ka një plan specifik për jetën tënde. Ai nuk ka premtuar se do të jetë e lehtë apo pa dhimbje, por Ai ka thënë se do të ecë me ty. Sot, je i bekuar që ke mundësinë t'ua mësosh këtë gjë nxënësve. Merre seriozisht rolin tënd dhe mëso me bindje dhe entuziazëm.

Ide krijuese për mësimin biblik:

1. Vizato paraprakisht një pemë familjeje në tabelë për “prezantimin e tremujorit”.
2. Gjej objekte argëtuese për shpjegimin e mësimi, si për shembull: një pelerinë me shumë ngjyra, paruke/kapele, figura që përfaqësojnë vëllezërit, etj.
3. Jepu nxënësve letra ku shkruhet “Perëndia ka një plan”. Ndërsa shpjegon, kërkoju nxënësve të nxjerrin letrën sa herë që ti thua: “Perëndia ka/kishte një plan.”
4. Krijë paraprakisht një rebus (ang. *puzzle*) me vargjet kyç apo pamje nga mësimi. Ndërsa shpjegon, bashko copëzat e “pamjes së madhe”.
5. Vish një pelerinë me shumë ngjyra ndërsa shpjegon.

NISU

Loja e përsëritjes para shërbesës, dhe adhurimi

Drejtesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritëse, e ndjekur nga adhurimi. Hollësitat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: Cili është plani!


Qëllimi: T'i prezantojmë nxënësit me konceptin se Perëndia ka një plan për jetën e tyre.

Aktiviteti: Hapësirë jashtë

Shënim: Aktiviteti duhet bërë në dy grupe në dy vende të ndryshme.


Përmbledhje e aktivitetit të “Kohës së zbulimit”:

1. Nxënësit do të punojnë së bashku në skuadra, për të plotësuar gjashtë sfida të ndryshme.
2. Në secilin stacion, secila skuadër do të marrë një copëz të “puzzle”-it pasi të ketë përfunduar sfidën e skuadrës.
3. Secila copëz në fund do të formojë rebusin ku shkruhet “Perëndia ka një plan për jetën time.”
4. Skuadra e parë që formon rebusin, fiton!



Mjetet:

- Gjashtë kartonë për stacionet (secili karton do të ketë të shkruar numrin e stacionit dhe udhëzimet për atë stacion) (burim i printueshëm)
- Copëza rebusi, ku shkruhet “Perëndia ka një plan për jetën time!” (Nga një rebus për çdo skuadër; çdo rebus duhet printuar në karton, pastaj duhet prerë në gjashtë pjesë dhe pjesët duhen shpërndarë tek kutitë e thesarit.) (burim i printueshëm)



- Gjashtë kuti thesari (nga një për çdo stacion; secila kuti thesari në stacionet e ndryshme duhet të ketë një copëz specifike të rebusit – sigurohu të ketë nga një copëz për çdo skuadër).
- Konë ose flamuj për të krijuar gjashtë stacionet (secili stacion duhet të ketë një karton ku shënohet sfida dhe një kuti thesari me copëzat e rebusit; stacioni 4 dhe 6 do të kenë nevojë për disa mjete shtesë që listohen më poshtë).
- Frisbi, një rreth të madh dhe një vijë nga e cila do të hidhet frisbi (për stacionin 4).
- Tullumbace të mëdha me ujë për secilën skuadër në kova/legenë (për stacionin 6).
- Një bazë ku secila skuadër do të formojë rebusin.
- Një drejtues – zgjidh një drejtues që do të mbikëqyrë të gjithë aktivitetin e KZ-së; drejtuesi do të lëvizë tek të gjithë stacionet dhe do të verifikojë fituesit; ky person duhet të njohë rregullat dhe të nxisë entuziazëm për garën.
- Etiketa shpërblyese, pije ose diçka për të ngrënë (çmime për secilin anëtar të skuadrës fituese).
- Bilbil ose zile për fillimin e garës.

Stacionet: (mund të përshtaten nga drejtuesi sipas nevojës)

- Stacioni 1: Hiqni këpucët dhe bëni një piramidë të madhe me këpucë.
- Stacioni 2: Formoni një rreth dhe bërtisni si skuadër: “Perëndia ka një **plan** për _____!” Me radhë, thoni emrin e secilit nxënës.
- Stacioni 3: Skuadrat duhet të formojnë fjalën “**plan**” me këpucët e tyre.
- Stacioni 4: Duhet të hidhni pesë frizbi tek rrathët (ose vendosni një objekt tjetër). Vendosuni në radhë dhe secili të përpiqet të shënojë.
- Stacioni 5: Secili anëtar duhet t’i japë dorën anëtarëve të tjerë. Drejtuesi sigurohet që të gjithë t’i japin dorën secilit.
- Stacioni 6: Skuadra duhet të vendoset në rresht në vijë të drejtë dhe nga personi i parë të kalojë sipër kokës një tullumbace e madhe me ujë deri tek i fundit. Tullumbacja duhet të kalojë nga fillimi në fund pa plasur. Nëse tullumbacja plas, duhet të filloni nga fillimi. Mund ta bëni më të vështirë, duke rritur numrin e tullumbacave që duhet të kalojnë.

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së dhe drejtuesin e lojës:

1. **Drejtuesi duhet të thotë:** Sot kemi një plan për ju! Thekso fjalën “**plan**”. Keni gjashtë stacione të ndryshme sfidash. Si skuadër, duhet të përfundoni çdo sfidë për të fituar copëzën e rebusit që gjendet në atë stacion. Stacionet nuk duhet patjetër të ndiqen sipas radhës. Kur skuadra të ketë mbledhur të gjashtë copëzat e rebusit, do të nxitoni për tek baza dhe do t’i vendosni copëzat siç duhet, sa më

shpejt të mundeni. Skuadra e parë që formon rebusin fiton pesë etiketa shpërblyese për secilin anëtar (ose cilido qoftë çmimi që keni zgjedhur). Paralajmërim: Nëse merrni ndonjë nga copëzat e rebusit pa përfunduar sfidën, skuadra juaj skualifikohet! A e dëgjuat planin? A jeni gati?

2. **Drejtuesi** t'i bjerë bilbilit apo ziles për të filluar garën!
3. **Trajnerët (drejtuesit e KZ-së)**: Mbikëqyrni me kujdes skuadrat tuaja për t'u siguruar që i përfundojnë sfidat dhe mbledhin të gjitha copëzat e rebusit.
4. **Mësuesit dhe kujdestarët**: Ndhmoni me rreshtimin e nxënësve dhe përqendrimin e tyre gjatë aktivitetit. Ndhmoni nxënësit më të vegjël dhe inkurajojini të mëdhenjtë të përpiqen t'ia dalin vetë.
5. **Drejtuesi**: shiko me kujdes bazën për të përcaktuar fituesin.
6. **Drejtuesi**: shpërble anëtarët e skuadrës fituese me pesë etiketa shpërblyese, ose me një çmim që e keni vendosur.

Këshilla për drejtuesin:

1. Drejtuesit duhet të vijnë më herët për të kuptuar mirë stacionet para se të fillojë sfida.
2. Duke qenë se është mësimi i parë i tremujorit dhe mund të ketë ndryshime, njihuni më mirë me nxënësit tuaj.
3. Shpjegojini qartë rregullat. Mund të ketë zhurmë, ndaj sigurohuni që nxënësit të jenë të vëmendshëm dhe të kuptojnë.
4. Drejtuesit duhet të nxisin skuadrën e tyre para fillimit të aktivitetit. Secila skuadër mund të brohorasë për veten para se të fillojë sfida.
5. Zbukurojini stacionet me flamuj, tullumbace ose objekte të tjera, që aktiviteti të jetë sa më argëtues.

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesit kryesorë – Lidhja e KZ-së me mësimin: A kishte një **plan** për aktivitetin e Kohës së zbulimit? Cili ishte plani? (të përfundoheshin gjashtë sfidat për të plotësuar rebusin) Çfarë shkruhej tek rebusi? (Perëndia ka një **plan** për jetën time!). A mendon ndonjëherë për këtë – që Perëndia ka një **plan** për jetën tënde? Jo një **plan** të çfarëdoshëm, por një **plan** shumë të veçantë të bërë për ty. Çfarë mendon se do të jetë më mirë për ty – të bësh **planin** tënd për veten apo të ndjekësh **planin** e Perëndisë? Sot do të mësojmë për një person që ka jetuar shumë kohë më parë. Sot, do të dëgjoni sesi Perëndia kishte një **plan** shumë të veçantë për jetën e tij.

Çështje shtesë për nxënësit më të rritur: Perëndia nuk e shfaq gjithë planin e Tij për jetën tënde menjëherë. Duhet kohë – Ai i jep copëzat e rebusit me radhë. Qëllimi yt është të jesh i përqendruar tek Perëndia dhe t'i bindesh Atij, që të dëgjosh dhe të kuptosh drejtimin e Tij për jetën tënde!

Lutu: Në fillim të mësimit, inkurajo njerin nga nxënësit që të ngrihet në këmbë dhe me guxim të drejtojë klasën në lutje. Kujtoju nxënësve që është nder të drejtosh klasën në një bisedë me Perëndinë. Çfarë duhet të bëjnë nxënësit gjatë lutjes? Të dëgjojnë dhe të luten bashkë me personin që po drejton lutjen.

Zbuloje: A është Zanafilla në Dhiatën e Vjetër apo në Dhiatën e Re? (Dh.V) Zanafilla është libri i parë i Biblës dhe është shkruar nga Moisiu për njerëzit e Izraelit. Shkruaj në tabelë referencën e vargut të Zanafilla 37:1 dhe kërkoju nxënësve t'i hapin Biblat të Zanafilla 37:1. Mësoji se referenca është “adresa” e vargut në Bibël. Kujtoju nxënësve se Zanafilla është libri, numri i parë, 37, është kapitulli dhe numri i dytë, 1, është vargu. Nxënësit më të vegjël ose ata që janë për herë të parë mund të kenë nevojë për ndihmë. Mund të përdorni edhe metodën “Stërvitja me shpata”.

Kronologjia: Drejtoje gishtin tek njerëzit e “Prezantimit me tremujorin dhe mësimin nga Bibla” (shih më poshtë) tek kronologjia biblike ndërsa shpjegon.

Prezantim me tremujorin dhe mësimin nga Bibla: Tremujorin e kaluar, ishim në Dhiatën e Re duke mësuar për apostullin Pal në librin e Veprave. Këtë tremujor, rikthehemi në Dhiatën e Vjetër për të studiuar librin e Zanafillës, në pikën ku e kishim lënë. A e kujton ndonjëri prej jush se çfarë do të thotë fjala “zanafillë”? (do të thotë fillim ose nisje) Le të rishikojmë shpejt kronologjinë e Biblës për të kujtuar se çfarë ndodhi pasi Perëndia krijoi botën. Drejtohu te kronologjia ndërsa përsërit pikat e mëposhtme:

Për cilët njerëz kemi mësuar këtë vit? (Adami dhe Eva, Kaini dhe Abeli, Noeu, Abrahami dhe Sara, dhe biri i tyre Isaku) Isaku kishte dy bij dhe emrat e tyre ishin Jakobi dhe Esau. Sot, do të fillojmë të mësojmë për familjen e Jakobit. Kujtoni që, familja e Jakobit ishte pjesë e familjes së Abrahamit. A e gjen dot ndonjëri nga ju se sa fëmijë kishte Jakobi? (dymbëdhjetë) Një nga bijtë e Jakobit quhej Jozef. Jozefi ishte biri i njëmbëdhjetë i Jakobit. E po, çfarë na tregon Bibla për Jozefin? Le të mësojmë për të tani.

Përvijimi i Shkrimit: Zanafilla 37

Jozefi i tregon Jakobit për namin e keq të sjelljes së vëllezërve të tij

Parafrazim i Zanafilla 37:1-2:

Jakobi dhe dymbëdhjetë bijtë e tij jetonin në tokën e Kanaanit. Kanaani ishte toka që Perëndia i kishte premtuar familjes së Abrahamit. Jozefi dhe vëllezërit e tij ishin barinj. Një ditë, Jozefi shkoi tek babai i tij, Jakobi, dhe i tregoi se sjellja e vëllezërve ishte e keqe. Si mendoni se u ndien vëllezërit për spiunimin e Jozefit? Para se të përgjigjeni, dëgjoni këtë.

Jozefi është djali i preferuar i Jakobit

Lexo Zanafilla 37:3-4

Përmbledhje: Jakobi quhej gjithashtu “Izrael”. Nga këto vargje mësojmë se Jakobi, ose Izraeli, e donte birin e tij Jozef më shumë se bijtë e tjerë, dhe ai madje i dha Jozefit një “rrobë të gjatë deri te këmbët”.

Çfarë? Prindërit nuk duhet të kenë një fëmijë të preferuar. Vëllezërit e Jozefit e urrenin atë, sepse ai ishte i preferuari i babait. Dhe situata u bë edhe më keq.... Dëgjoni.

Jozefi sheh një ëndërr dhe tregon se çfarë do të ndodhë

Lexo Zanafilla 37:5-11

Përmbledhje: Jozefi sheh ëndërra që i tregojnë se një ditë do të sundojë mbi vëllezërit e tij. Tani e urrenin vërtet vëllezërit, dhe ishin xhelozë për të! Të urresh dikë dhe të jesh xheloz për të është mëkat. Ishte një situatë familjare e tmerrshme. Por, diçka nuk ndryshonte. Perëndia kishte një plan për Jozefin dhe ne duhet të kuptojmë se, edhe kur gjërat duken shumë keq, ne mund t'i besojmë planit të Perëndisë. Le të zbulojmë më tepër për çfarë i ndodhi Jozefit dhe vëllezërve të tij.

Vëllezërit e Jozefit e shesin atë si skllav

Lexo Zanafilla 37:12-28

Ky është pasazh i gjatë, ndaj mos harro të lexosh me intonacion.

Përmbledhje: Oh, jo! Gjërat shkojnë nga keq në më keq. Vëllezërit e Jozefit e urrenin atë kaq shumë, saqë donin ta vrisnin. Por vëllai i tyre, Rubeni, ua mbushi mendjen të mos e bënin. Në vend të kësaj, ata e shitën Jozefin si skllav, dhe ai u mor në Egjipt.

Mbyllini sytë për një moment dhe mendoni. Po sikur t'ju ndodhte juve? Po sikur vëllezërit apo motrat tuaja t'ju shisnin si skllav në një vend të huaj dhe t'ju largonin nga shtëpia? Si mendoni se u ndie Jozefi? Lejoji nxënësit t'i referohen shkurtimisht posterit “Ndihë si duhet” dhe të shpalosin mendimet e tyre. Çfarë mësuat në aktivitetin e “Kohës së zbulimit”? (Perëndia ka një plan për jetën time) E gjithë kjo që po i ndodhte Jozefit, a mund të ishte pjesë e planit të Perëndisë? Shitja e Jozefit si skllav nuk ishte e vetmja gjë që bënte vëllezërit e Jozefit.... Dëgjoni.

Vëllezërit e Jozefit e bindën Jakobin se Jozefin e kishin vlarë

Lexo Zanafilla 37:29-36

Përmbledhje: Jo vetëm që vëllezërit e shitën Jozefin në një vend të huaj, por ata i thanë babait të tyre se Jozefin e kishin vlarë kafshët e egra. A ishte e vërtetë kjo? (Jo) Çfarë i quajmë këto të këqija që bënte vëllezërit e Jozefit? (Mëkat)

Përfundimi

Ndoshta po mendon me vete: “Po sikur, Perëndia kishte një plan për Jozefin, apo jo?”. A ishte e gjithë kjo pjesë e planit të Perëndisë? E po, Perëndia kurrë nuk do që njerëzit të mëkatojnë, dhe vëllezërit e Jozefit mëkatuan shumë herë! Ata e trajtuan edhe Jozefin, edhe babain e tyre në mënyrë të tmerrshme. Por, edhe pse njerëzit mëkatojnë dhe i bëjnë gjërat në mënyrën e tyre dhe jo siç i pëlqen Perëndisë, Perëndia vazhdon të ketë një plan për ta. Perëndia e plotëson gjithmonë planin e Tij. Vargu nga “Mendo si duhet” na kujton t’i besojmë planit të Perëndisë. Le ta themi tani. Recitoni Fjalët e Urta 3:5-6.

Le të mendojmë pak për disa mënyra se si mund të shohim planin e Perëndisë për Jozefin gjatë këtyre gjërave të tmerrshme që i ndodhën.

- Kush mendoni se ia dha Jozefit ëndrrat për atë që do të ndodhte në të ardhmen? (Perëndia)
- Kush mendoni se e përdori Rubenin për të shpëtuar jetën e Jozefit? (Perëndia)
- Kush mendoni se donte që Jozefi të shkonte në Egjipt? (Perëndia)

Disa prej këtyre gjërave janë të vështira për t’u kuptuar tani, por sa më shumë mësojmë për Jozefin, aq më shumë do të mund të shohim plotësimin e planit të Perëndisë për jetën e tij! Javën e ardhshme do të mësojmë më tepër për planin e Perëndisë për Jozefin. Më besoni – nuk do të donit ta humbisnit! Kërkojuni prindërve t’ju sjellin sërish javën e ardhshme, që të mësoni më shumë për Jozefin.

“Vepra si duhet” dhe “Ndihi si duhet”

Jozefit po i ndodhnin gjëra vërtet të këqija. A të ka ndodhur ndonjëherë diçka e keqe? Jeta është plot me sfida të vështira; disa mund të jenë të lehta, siç ishin sfidat e KZ-së sot. Por sfida të tjera do të jenë shumë të vështira. Çfarë bën kur vijnë këto sfida të vështira? Për çfarë mendon? A e kujton se duhet t’i besosh Zotit me gjithë zemrën tënde apo mbështetesh në gjykimin tënd? Kujto që Perëndia dëshiron që t’i besosh Atij dhe t’i bësh gjërat sipas mënyrës së Tij. Kur e bën këtë, Ai do të drejtojë shtigjet e tua. Kjo do të thotë se Ai do të na e qartësojë rrugën. Si ndihesh kur kujton se Perëndia, që krijoi të gjithë botën, ka një plan për jetën tënde? Shpresoj që do të të bëjë të ndihesh i dashur nga Perëndia.

A e di se cila është pjesa e parë e planit të Perëndisë për ty? Që ti t’i besosh Jezusit për të shpëtuar nga mëkati yt, që të kesh jetë të përjetshme me Të. A e ke bërë zgjedhjen për t’i besuar Jezusit? Nëse nuk e ke bërë, mund ta bësh sot. Le të sigurohemi që e kuptojmë se çfarë do të thotë të besosh në Jezusin. Dhe nëse ke besuar në Jezusin, mund t’u tregosh të tjerëve si të besojnë tek Ai, ndaj dëgjo me vëmendje. Shpalle Ungjillin përmes “Librit pa fjalë” dhe bëj ftesë për shpëtim.

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

*Drejtuesi i KZ-së apo bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje.
Te shtojca ka ide për lojëra.*

1. Si quhej toka ku jetonte familja e Jozefit? (Kanaan)
2. Çfarë i dha Jakobi Jozefit? (një rrobë të gjatë)
3. Përse ia dha Jakobi rrobën Jozefit? (Ai e donte Jozefin më shumë se bijtë e tjerë)
4. Çfarë kuptimi kishte ëndrra e Jozefit? (Një ditë ai do të sundonte mbi vëllezërit e tij)
5. Çfarë i bënë vëllezërit Jozefit? (E shitën si skllav në Egjipt)
6. Çfarë donin vëllezërit që Jakobi të besonte për Jozefin? (Që ai ishte vrarë nga kafshët e egra)
7. Si mund ta shohim planin e Perëndisë në jetën e Jozefit? (Ëndrrat e Jozefit, mbrojtja që mori nga Rubeni, Jozefi shkoi në Egjipt)
8. A është gjithmonë e lehtë të kuptojmë planet e Perëndisë? (Jo)
9. A e beson që Perëndia ka një plan për jetën tënde?